



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

SKEMË VLERËSIMI
FILOZOFI - SOCIOLOGJI

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1 B 1 pikë

Pyetja 2 D 1 pikë

Pyetja 3 2 pikë

Model përgjigjeje:

- Vlera kulturore e mikpritjes në shoqërinë tradicionale shqiptare ishte shumë e rëndësishme sepse në mungesë të nëpunësve të organeve shtetërore, miku (i respektuar dhe i nderuar në mënyrë të veçantë) kryente funksione shoqërore të rëndësishme:
 - në fejesa, martesë të rinjve;
 - në zbutje, kapërcim të konflikteve, faje gjaku;
 - për burim informacioni;
 - këshillues për vendime të rëndësishme;
 - organizator në veprimtari të përbashkëta, si ndërtim urash, luftë kundër pushtuesve;
 - zgjidhja e bashkëjetesës, etj.

2 pikë nëse argumenton rëndësinë e mikpritjes nëpërmjet dy funksioneve të mikut në shoqëri;
1 pikë nëse argumenton rëndësinë e mikpritjes nëpërmjet një funksioni të mikut në shoqëri;
0 pikë nëse shkruan për mikpritjen pa dhënë funksione të mikut në shoqëri **OSE** përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 4 3 pikë

Model përgjigjeje:

- Vetja shoqërore jo që në lindje - Mid pohon se vetja shoqërore nuk është e njëjtë me trupin si diçka biologjike, por ajo krijohet si rrjedhojë e përvojës shoqërore.
- Përvojë përmes simboleve të njësuara - Individit komunikon me përvojën shoqërore me anë të kuptimeve të njësuara të simboleve, çka i dallon njerëzit nga kafshët më të zhvilluara. Nje riu i kupton sjelljet e veta dhe të tjerëve.
- Marrje e rolit të tjetrit - Duke u përpjekur të kuptojnë qëllimet e të tjerëve, njerëzit aftësohen për të njohur pikëpamjet e njëri-tjetrit. Përgjithësisht, çdo njeri kupton se si një person tjetër mund të reagojë ndaj tij, duke imagjinuar veten në rolin e tjetrit. Duke përdorur simbolet në ndërveprimin shoqëror, njerëzit përgjithësisht e shohin veten sikurse të tjerët i shohin ata. Mid e quan këtë proces si marrje e rolit të tjetrit.

3 pikë	nëse shpjegon tri aspektet e mësipërme;
2 pikë	nëse shpjegon dy nga aspektet e mësipërme;
1 pikë	nëse shpjegon një nga aspektet e mësipërme;
0 pikë	nëse vetëm i përmend tri aspektet e mësipërme, përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 **A** **1 pikë**

Pyetja 6 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

- a) Mendimi dhe veprimi nuk është devijues në vetvete. Ai vlerësohet si deviant në raport me vlerat dhe normat e një kulture të caktuar si psh:
 - Vlerësimi i abortit si sjellje deviante ose jo në shoqëri të ndryshme
 - Pirja e alkoolit si sjellje deviante në kultura të ndryshme, etj.
- b) Një veprim mund të quhet deviant ose jo edhe nga rrethana të veçanta shoqërore si psh:
 - Vrasja e një njeriu në kushte paqeje është krim. Vrasja e pushtuesit të vendit tënd në kushte lufte të drejtë nuk quhet e tillë. Ajo nderohet si akt heroik.
 - Në regjimin komunist dënohej çdo njeri që bënte propagandë anti parti-shtet.
 - Gjakmarrja në krahina të ndryshme të vendit tonë ishte një detyrim për meshkujt e rritur të familjes. Në atë kohë quhej sjellje tradicionale ndërsa sot ajo dënohet me ligj si krim i rëndë, etj.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

2 pikë	nëse shkruan përkatësisht një shembull edhe për faktorin a) edhe për faktorin b);
1 pikë	nëse shkruan një shembull vetëm për një faktor;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 7 **3 pikë**

Model përgjigjeje:

Familja bërthamë e mbylltur ka këto tipare:

- është faza e tretë e zhvillimit të familjes;
- grup i vogël personash (1-5 anëtarë);
- ndikohet pak ose aspak nga lidhjet fisnore;
- ka një peshë specifike e saj;
- anëtarët janë shumë të lidhur emocionalisht me njëri-tjetrin;
- ndjenja e dashurisë luan rolin vendimtar në përzgjedhjen e partnerëve;
- e përhapur në vendet e zhvilluara perëndimore.

3 pikë	nëse identifikon tri tipare;
2 pikë	nëse identifikon dy tipare;
1 pikë	nëse identifikon një tipar;
0 pikë	nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigje e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Pyetja 8 D 1 pikë

Pyetja 9 2 pikë

Model përgjigjeje:

Asimilimi shfaqet:

- në modele ku anëtarët e pakicave ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës për tu shkrirë me modele të kulturës sunduese të shoqërisë. Njerëzit ndryshojnë emrin dhe mbiemrin e tyre, mënyrën e veshjes, vlerat dhe normat kulturore, gjuhën, fenë, etj.
- në raste të një përshtatjeje ndaj kulturës së grupit sundues dhe jo në shkrirje të plotë pasi individët shpesh përpiqen të ruajnë pjesërisht traditat kulturore të vendit nga kanë ardhur.

2 pikë nëse shkruan dy aspekte;
 1 pikë nëse shkruan një aspekt;
 0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 A 1 pikë

Pyetja 11 D 1 pikë

Pyetja 12 2 pikë

Model përgjigjeje:

- Feja e njëjtë si faktor uniteti shoqëror.
 - Ceremonitë dhe ritualet e praktikuara kolektivisht.
 - Predikimi, kontrolli dhe zbatimi i normave të njëjta.
 - Solidariteti i grupit shoqëror, për shkak të riteve ceremoniale të ndryshme.
 - Po përhapen fe apo rryma që kultivojnë tolerancën fetare.
 - Bashkimi i njerëzve në një familje të përbashkët.
 - Krijimi i një qytetërimi tërësor.
- Dallimet fetare si burim mosmarrëveshesh.
 - Ndyshimet në besimet fetare shpesh kanë shërbyer si bazë e ndasive dhe konflikteve mes njerëzve brenda shoqërive të caktuara.
 - Ndyshimet në besimet fetare kanë shërbyer edhe si burim konfliktesh ndërmjet shoqërive të ndyshme.
 - Kryqëzatat në shek XI-XII etj.

2 pikë nëse shpjegon rolin e fesë si faktor uniteti shoqëror me një argument përkatës **dhe** rolin e fesë si burim mosmarrëveshesh me një argument përkatës;
 1 pikë nëse shpjegon rolin e fesë si faktor uniteti shoqëror me një argument përkatës **ose** rolin e fesë si burim mosmarrëveshesh me një argument përkatës;
 0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim që nuk është parashikuar në skemën e vlerësimit por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Pyetja 13 **B** **1 pikë**

Pyetja 14 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

- Qyteti/Fshati
 - Masa e madhe/vogël e popullsisë.
 - Vendbanim i dendur/rrallë.
 - Shumëllojshmëria/njëtrajtshmëria shoqërore.
 - Popullsi heterogjene/homogjene.
 - Toleranca/intoleranca ndaj ndryshimeve shoqërore dhe kulturore.
 - Njohje të sipërfaqshme/të thella.
 - Komunikimet më të shpeshta/rralla me grupe shoqërore të ndryshme.
 - Zbehja/forcimi e ndjenjës së bashkësisë.
 - Liria individuale/varësia nga opinioni.
 - Larmishmëria dhe intensiteti/monotomia i jetës social-kulturore dhe politike.
 - Pasiguria dhe stresi/siguria dhe qetësia.
 - Dobësimi/forcimi i ndërveprimit social.
 - Etj.

2 pikë nëse shkruan saktë dy ndryshime ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës;
1 pikë nëse shkruan saktë një ndryshim ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **A** **1 pikë**

Pyetja 16 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

- Tipare të shtresimit shoqëror:
 - është veçori e shoqërisë, pavarësisht nga vullneti i individëve të veçantë;
 - është i përgjithshëm, por me tipare të veçanta në çdo shoqëri;
 - vazhdon gjatë disa brezave dhe trashëgohet nga prindërit te fëmijët;
 - mbështetet nga modele kulturore, nga bindje të natyrave të ndryshme.

2 pikë nëse shkruan dy tipare të shtresimit shoqëror;
1 pikë nëse shkruan një tipar të shtresimit shoqëror;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **B** **1 pikë**

Pyetja 18 **D** **1 pikë**

Pyetja 19 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

- Intervista e lirë sociologjike:
 - karakterizohet nga lirshmëria në komunikim;
 - përgjithësisht realizohet në trajtën e bisedave të lira;
 - nuk organizohet sipas një rradhe të caktuar;
 - zakonisht përbëhet nga pyetje të hapura;
 - mund të ketë edhe pyetje të paparashikuara më parë nga studiuesi.

2 pikë nëse shkruan dy tipare të intervistës së lirë sociologjike;

1 pikë nëse shkruan një tipar të intervistës së lirë sociologjike;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **A** **1 pikë**

Pyetja 21 **D** **1 pikë**

Pyetja 22 **A** **1 pikë**

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

a) Nëpërmjet shprehjes “**Nuk mund të lahesh dy herë në ujërat e të njëjtit lumë**” Herakliti do të thotë se:

- Gjithçka rrjedh dhe është në ndryshim të vazhdueshëm.

Ose -Gjithçka transformohet por nuk mohohet harmonia e rregullit në botë.

Ose -Gjithçka kalon nga një gjendje në një tjetër.

b) Ky ndryshim ndodh si rezultat i luftës së të kundërtave si p.sh.: (dita/nata), (e mira/e keqja) etj.

2 pikë nëse shpjegon **a) edhe b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

1 pikë nëse shpjegon **a) ose b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me to;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë****Modele përgjigjeje:**

a) - Përvoja shqisore është themeli i njohjes.

Ose- Të dhënat shqisore janë të pagabueshme.

Ose- Ndijimet dhe perceptimet janë baza e njohjes njerëzore.

b) Shqisat bëjnë një farë regjistrimi të objekteve kështu përfytyrimi i objekteve është i mundur edhe në mungesë të tyre.

Ose- Ndijimet e mëparshme të përsëritura mbeten te njeriu si kujtesë. Kështu njohim sendet dhe komunikojmë me njerëzit.

Ose- Përmes memorizimit të këtyre përvojave jemi në gjendje të njohim realitetin.

2 pikë nëse shpjegon **a) edhe b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me një nga modelet e dhëna;

1 pikë nëse shpjegon **a) ose b)** si më sipër ose në mënyrë të ngjashme me një nga modelet e dhëna;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 D 1 pikë

Pyetja 26 B 1 pikë

Pyetja 27 D 1 pikë

Pyetja 28 3 pikë

Model përgjigjeje:

- Dy dashuri kanë ndërtuar dy qytete. Dashuria për veten, deri në përbuzje të Zotit, ka ndërtuar qytetin tokësor. Dashuria për Zotin, deri në përbuzje të vetes, ka ndërtuar qytetin qiellor, ose të Zotit.
- Qyteti tokësor është komuniteti i atyre që jetojnë sipas trupit, mishit, ndërsa ai i Zotit, është i atyre që jetojnë sipas shpirtit. Aty janë të zgjedhurit e Zotit.
- Këto qytete dallohen nga vlerat që mbartin komunitetet e tyre, nga qëllimi i dashurisë së tyre.
- Agustini nuk i barazon qytetet me institucionet respektive: shteti dhe kisha. Shteti nuk ka vlera mbinatyrore. Nuk ka të bëjë me shpëtimin tejtokësor, ndërsa kisha është instrument për të ndërtuar qytetin e Zotit.
- Dy qytetet bashkëjetojnë në luftë me njëri-tjetrin.

3 pikë nëse jep në mënyrë krahasuese tri tipare për qytetet që kërkohen;
2 pikë nëse jep në mënyrë krahasuese dy tipare për qytetet që kërkohen;
1 pikë nëse jep në mënyrë krahasuese një tipar për qytetet që kërkohen;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 D 1 pikë

Pyetja 30 3 pikë

Model përgjigjeje:

- a) Burojnë nga antropocentrizmi (prijja që ta shikojmë realitetin sipas masës njerëzore) apo nga prija e natyrshme për të thjeshtuar gjërat.
- b) Paragjykimet dhe pasionet individuale prej natyrës unike të individit (rezultat i edukimit dhe zakoneve tona).
- c) Gabimet nga teoritë e ndryshme filozofike që sjellin kuptime jo të vërteta të realitetit si ato në skenën e një teatri.

3 pikë nëse identifikon thelbin e tri idhujve të analizuar nga Frensis Bekon;
2 pikë nëse identifikon thelbin e dy idhujve të analizuar nga Frensis Bekon;
1 pikë nëse identifikon thelbin e një idhulli të analizuar nga Frensis Bekon;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 A 1 pikë

Pyetja 32 C 1 pikë

Pyetja 33 **2 pikë**
Model përgjigjeje:

Monteskië vlerëson ndikimin e faktorëve si:

- klima;
- feja;
- veçoritë gjeografike;
- historia;
- rregullat morale të mësuara;
- zakonet;
- tradita;
- përputhshmëria me ligjet natyrore;
- shpirti i popujve, mënyra e jetesës së tyre etj.

- 2 pikë** nëse identikon dy faktorë që duhet të mbahen parasysh në hartimin e ligjeve sipas Monteskië;
- 1 pikë** nëse identikon një faktor që duhet të mbahet parasysh në hartimin e ligjeve sipas Monteskië;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 34 **A** **1 pikë**

Pyetja 35 **3 pikë**
Model përgjigjeje:

- a) Burimi i këtij mendimi është teza themelore e Hegelit: **“Çdo gjë reale është racionale dhe çdo gjë që është racionale është reale”**.
- b) Aspektet kryesore të kësaj teze janë:
- a) Realiteti është i aftë të shprehët në kategori racionale.
 - b) Racionalja është thebi i vetë realitetit, parim i përhershëm për gjërat.
 - c) Realja nuk është irracionale, e paarsyeshme. Kjo do të thotë se ajo që ekziston mund të njihet.
 - d) E vërteta, absolutja, nuk është e pakapshme.

- 3 pikë** nëse evidenton tezën e Hegelit dhe shpjegon dy aspekte nga teza themelore e tij;
- 2 pikë** nëse evidenton tezën e Hegelit dhe shpjegon një aspekt nga teza themelore e tij;
- OSE**
- 2 pikë** nëse shpjegon dy aspekte nga teza themelore e tij;
- 1 pikë** nëse evidenton tezën e Hegelit;
- OSE**
- 1 pikë** nëse shpjegon një aspekt nga teza themelore e Hegelit;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 36

2 pikë

Model përgjigjeje

- Në këtë stad njeriu drejtohet nga nevoja të tilla si bukuria dhe kënaqësia.
- Njeriu mund të shkelë rregullat morale për hir të kënaqësive.
- Njeriu përpiket të shfrytëzojë të gjitha burimet e kënaqësisë që i jep jeta.
- Këtu njeriu nuk ndihet shumë i përgjegjshëm për zgjedhjet e tij. Liria është e plotë. Njeriu është i gatshëm të shkelë rregullat morale për hir të kënaqësive.

2 pikë

nëse identifikon dy veçori të stadii estetik të Kirkegardit;

1 pikë

nëse identifikon një veçori të stadii estetik të Kirkegardit;

0 pikë

nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 37

3 pikë

Model përgjigjeje:

- 1. Ekzistencializmi i Sartrit është ateist sepse nuk e merr në konsideratë ekzistencën e Zotit./Ekzistenca e këtij të fundit nuk do përbënte ndonjë ndryshim për thelbin e njeriut./Njeriu nuk ka një esencë të paracaktuar nga Zoti.
- 2. Nuk ka një paracaktim të thelbit të njeriut, por ky i fundit duke ekzistuar e krijon thelbin e tij./Njeriu është i dënuar që të jetë i lirë, ai ka përgjegjësinë absolute të krijimit të thelbit të tij. Njeriu ka dy mënyra të kuptimit të ekzistencës së tij: mohimi dhe tjetri.
- 3. Duke krijuar këtë thelb, ai përjeton ankth sepse nuk ka një siguri absolute për zgjedhjen që bën./Këtë thelb ai e krijon vazhdimisht duke ekzistuar nën ankth.

3 pikë

nëse shpjegon këtë parim të ekzistencializmit duke u mbështetur tek arsyetimet e mësipërme ose të ngjashme me to, por duke theksuar: **1.** Indiferencën e këtij ekzistencializmi ndaj Zotit; **2.** Lirinë dhe përgjegjësinë që e shoqëron individin gjatë të ekzistuarit; **3.** Ankthin që përjeton individi përderisa asgjë nuk e garanton për zgjedhjen;

2 pikë

nëse shpjegon këtë parim të ekzistencializmit duke theksuar vetëm dy nga këto pika kryesore;

1 pikë

nëse shpjegon këtë parim të ekzistencializmit duke theksuar vetëm një nga këto pika kryesore;

0 pikë

nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.